



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.5.2023

Nr: 535

Ora: 19:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR
KRYETAR TË BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA
LUSHNJË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 20.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Lushnjë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 2 (dy) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 54 dhe ZAZ nr. 55.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Lushnjë.

Data: 20.5.2023 Nr: 535
Ora: 19:00



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Lushnjë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Bazuar në nenin 123, pika 1, të Kodit Zgjedhor është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

KZAZ nr. 54 dhe KZAZ nr. 55 kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Lushnjë dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Lushnjë, u kontrolluan tabelat përmbledhëse të përkatësisht ZAZ nr. 54 dhe ZAZ nr. 55, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për Kryetarin ashtu edhe për Këshillin, përfshijnë rezultatit e të gjitha tabelave të rezultateve çdo QV-je, të zonës zgjedhore.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Lushnjë dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Lushnjë, Qarku Lushnjë, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të znj. Eriselda Sefa, si Kryetar i Bashkisë Lushnjë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Lushnjë, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË

BASHKIA LUSHNJE, QARKU FIER

Lidhja 1



		ZAZ 54	ZAZ 55	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	59.827	45.636	105.463
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	22.096	15.418	37.514
3	Vota të pavlefshme	850	728	1.578
4	Vota të vlefshme	21.190	14.656	35.846
1	Eriselda Musa Sefa	13.544	8.909	22.453
2	Eduart Shyqyri Sharka	7.646	5.747	13.393
	Totali i votave të vlefshme	21.190	14.656	35.846



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË

BASHKIA LUSHNJE, QARKU FIER



Lidhja 2

		ZAZ 54	ZAZ 55	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	59.827	45.636	105.463
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	22.096	15.413	37.509
3	Vota të pavlefshme	1.043	686	1.729
4	Vota të vlefshme	20.997	14.692	35.689
5	Flete votimi te hedhura gabim	56	35	91
1	Bashkë Fitojmë	3.293	2.326	5619
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	11.453	7.277	18730
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	670	223	893
4	Partia Republikane Shqiptare	613	474	1087
5	Partia Levizja e Legalitetit	282	546	828
6	Partia Demokracia Sociale	272	431	703
7	Aleanca Liberale e Djathtë	341	108	449
8	Partia Socialdemokrate	1.322	676	1998
9	Partia Demokratike	1.789	1.303	3092
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	196	360	556
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	347	642	989
19	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	419	326	745
	Totali i votave të vlefshme	20.997	14.692	35.689